



|  |                               |                               |                               |
|--|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Planuar / Dorezuar<br>Priljeno/Prodato<br>Received/Delivered | 13.06                         | 3                             | viti<br>god<br>year           |
| Organ /Njesia<br>Organ /Jednica<br>Org./Unit                 | Nr Prot<br>Br Prot<br>Prot No | Shtojca<br>Prilog<br>Appendix | Sasia<br>Kolicina<br>Quantity |
| SKIMSHICK  | 4731/2023                     |                               | 1/4                           |



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.760/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, si dhe Vjollca Sinani -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, duke vepruar sipas ankesës A.nr.760/2023 të datës 18.05.2023 të parashtruar nga ankuesi nga Prishtina, i përfaqësuar me autorizim nga kundër organit të punësimit Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, në çështjen juridike "kompensim material", në mbështetje të nenit 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenit 16 paragrafi 3 dhe nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 13.06.2023, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.760/2023 e datës 18.05.2023, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Nëpunësi civil i punësuar në Zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, në pozitën e punës Drejtor i Zyrës Administrative pran ZKM, më datë 18.05.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për kompensim për punën shtesë të angazhuar krahas pozitës së tij edhe në pozitën e Udhëheqësit të IT-së pran Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës/ZKM për dy vite radhazi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar vetëm Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 25.05.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Zyrën e Kryeministrit të



Republikës së Kosovës, ndërsa kjo e fundit me datë 26.05.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e trajtimit të ankesës ka administruar këto prova:** Ankesën me numër të protokollit 4345/2023 të datës 18.05.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesën për shtesa të IT-së e datës 30.08.2022; Vendimin me nr.02/39 e datës 08.10.2008; Lista dhe titujt e punonjësve që do të jenë përfitues të masave stimuluese duke përfshirë edhe shumën për këto pozita; Emailin e datës 12.05.2023; Akt Emërimit e ankuesit me nr.prot.590/2012 e datës 16.08.2012; Emailin e datës 29.04.2022; Vendim me nr.prot:268/2020 të datës 18.11.2020; Emailin e datës 05.12.2022; Vërejtje me ref.150/2022 e datës 22.06.2022; Emailin e datës 01.08.2022; Emailin e datës 18.05.2023; Autorizmi për Avokatin e datës 18.05.2023; Kërkesën për përgjigje e datës 25.05.2023; Përgjigjen në ankesë nga organi i punësimit e datës 26.05.2023; Akt Emërimit e ankuesit me nr.prot.148/2014 e datës 25.02.2014; Përshkrimi i detyrave të punës; Emailin e datës 04.05.2023; Emailin e datës 28.03.2022; Emailin e datës 06.12.2022; Emailin e datës 04.01.2023; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 19.10.2011; Vendimin me nr.07/29 e datës 31.07.2008; Kartela e nëpunësit për muajin Maj dhe Prill 2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkëngjitura në lëndë, të dërguara nga palët në procedurë, dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e pabazuar, sepse:

Nga administrimi i provave materiale Kolegji i këshillit ka gjetur se ankuesi në bazë të Akt Emërimit të datës 16.08.2012 dhe atij të datës 25.02.2014 është i punësuar në pozitën "Drejtor i Zyrës së Administratës Qendrore" në Zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës. Tutje sipas shkresave të lëndës, fillimisht më datë 30.08.2022, kishte parashtruar kërkesë tek Sekretari i Përgjithshëm në zyrën e Kryeministrit lidhur me kompensimin e shtesave në pagë për IT bazuar në Vendimin me shifër Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, po ashtu, ankuesi me datë 02.05.2023 e ka përsëritur kërkesën e tij tek Sekretari i Përgjithshëm lidhur me kompensimin e shtesave në pagë për IT bazuar në Vendimin me shifër Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ndërsa më datë 12.05.2023 ka pranuar një shkresë përmes emailit, përmes së cilës shkresë njoftohet në lidhje me përgjigjen që ka marrë në lidhje me kërkesën nga DMZP-ja, ndërsa ankuesi kundër këtij njoftimi të datës 12.05.2023 me datë 18.05.2023 ka parashtruar ankesë në Këshill.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se i takon kompensimi për shtesën mbi pagën bazë për Udhëheqës të Teknologjisë Informative sipas Vendimit me Nr. 02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në vlerën 500 Euro nga data 01.12.2020 deri më datë 31.12.2022, dhe të gjitha benefitet tjera në kuptim të kontributeve pensionale dhe tatimeve shtesë përkundër që nga shkresat e lëndës kolegji nuk ka arrit të gjejë asnjë shkresë që i njëjti është autorizuar apo ngarkuar me përgjegjësi që të kryej këto detyra të udhëheqësit të IT-së, përveç që e drejta e udhëheqjes së këtij shërbimi përmes vartësve të tij parashihet në përshkrim të detyrave të punës së tij.





Kolegji i këshillit bazuar në pretendimin ankimor konstaton se Kuvendi i Republikës së Kosovës, me datë 13.05.2010 ka aprovuar Ligjin Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil(i cili ligj kishte qenë në fuqi në kohën në të cilën ankuesi pretendon se ka ushtruar këtë detyrë),përmes të cilit është bërë përcaktimi i sistemit dhe strukturës së pagave, shtesave dhe kompensimeve të tjera për nëpunësit civilë, ndërsa me dispozitat e nenit 14 të këtij ligji është përcaktuar se: *1. Shtesat mbi pagën bazë janë: 1.1. shtesa për punë me ndërrime dhe jashtë orarit të punës; 1.2. shtesa për kushte specifike pune; dhe 1.3. shtesa për kushtet e tregut.* Përkitazi me këtë, duke u bazuar në dispozitat e nenit 27 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, Qeveria e Republikës së Kosovës, me datë 24.12.2012 kishte aprovuar Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përmes të cilës ka përcaktuar kushtet dhe procedurat për shtesat dhe kompensime të tjera mbi pagën bazë të nëpunësve civilë. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore janë shfuqizuar të gjitha aktet nënligjore të cilat kanë rregulluar shtesat dhe kompensimet tjera të nëpunësve civil, dhe rrjedhimisht edhe Vendimi Nr.02/39 i datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, konstatim ky i dhënë edhe në Raportin Vjetor të Vitit 2017 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa nga shkresat e lëndës poashtu nuk kemi hasur në ndonjë shkresë zyrtare që është adresuar sa i përket realizimit të kësaj kërkesë përkundër që ankuesi pretendon se nga data 01.12.2020 ushtron këto përgjegjësi shtesë, andaj duke pasur parasysh edhe faktin se ekzistojnë afatet ligjore të adresimit të kërkesave për realizim të ndonjë të drejte, Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor i ankuesit për realizimin e shtesës në pagë sipas Vendimit Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës ,është i pa bazuar.


Kolegji i Këshillit, poashtu konstaton se Kuvendi i Republikës së Kosovës, me datë 22.12.2022 ka aprovuar Ligjin Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, i cili me datë 05.01.2023 është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr.1/5 Janar 2023, dhe si rrjedhojë i njëjti ka hyrë në fuqi më datë 05.02.2023, dhe ku me nenin 45 paragrafi 2 ka përcaktuar se: *“Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet gjithashtu çdo dispozitë e ligjit apo e aktit nënligjor tjetër që rregullon çështjen e pagës, kompensimeve, shtesave, shpërblimeve apo kategorie tjetër në fushën e pagave, e që nuk është autorizuar shprehimisht për t’u nxjerr nga dispozitat e këtij ligji”* ndërlidhur me nenin 11 të Rregullores (MFPT) Nr. 02/2023 për Shtesën për Kushte të Tregut të Punës ku përcaktohet: *“Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet çdo akt nën-ligjor dhe dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë rregullore”,* Kolegji i Këshillit ka ardhur në konstatimin se Vendimi me Nr. 02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës mbi bazën e të cilit ankuesi kërkon që t’i aprovohet shtesa në pagë tani më është shfuqizuar dhe mbi këtë bazë ligjore andaj pretendimi ankimor i ankuesit është i pabazuar edhe mbi bazë të dispozitave të lartshënuara.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.760/2023, datë 13/06/2023.

Vjollca SINANI



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Vendimi i dërgohet:**

- Përfaqësuesit me autorizim,
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

